



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

ANNUAL BORROWING PLAN

PLANI VJETOR I HUAMARRJES

2024

Contents

Përmbajtja

- I. Gross Financing Needs for 2024
Nevojat e financimit për 2024
- II. Government Debt Redemptions in 2024
Maturimet e borxhit publik gjatë 2024
- III. Borrowing Plan for 2024
Plani i Huamarrjes për 2024
 - *Domestic Financing*
Financimi i Brendshëm
 - *Issuance Calendar for 2024*
Kalendari i Emetimeve për 2024
 - *External Financing*
Financimi i Jashtëm
- IV. Debt Management Strategy and Risk Indicators
Strategjia e Borxhit Publik dhe Indikatorët e Riskut

I. Gross Financing Needs for 2024

I. Nevojat e financimit për 2024

According to the 2024 Budget, the main fiscal indicators are presented as follows. The budget deficit is estimated at about **61.28 bln ALL** (2.5% of GDP).

Sipas Buxhetit 2024, treguesit kryesorë fiskal paraqiten si më poshtë. Deficiti buxhetor përlogaritet në rreth **61.28 mld lekë** (2.5% e PBB).

Main Fiscal Indicators		Bln ALL / Mld lekë	Indikatorët Kryesorë Fiskal	
(I)	Total Revenue	674.70	(I)	Totali i të Ardhurave
(II)	Total Expenditure	735.98	(II)	Totali i Shpenzimeve
<i>of which:</i>			<i>nga të cilat:</i>	
	<i>Current Expenditures</i>	<i>605.02</i>		<i>Shpenzime Korrente</i>
	<i>Capital Expenditures</i>	<i>128.46</i>		<i>Shpenzime Kapitale</i>
(I-II)	Budget Balance	(61.28)	(I-II)	Balanca buxhetore

Net domestic borrowing is expected to finance around 81.59% of the deficit (50 bln ALL) while the net external borrowing is expected in negative level. Remaining part of deficit is expected to be financed through the carried liquidity balance in 2023.

Huamarrja e brendshme pritet të financojë rreth 81.59% të deficitit (50 mld lekë), ndërkohë huamarrja neto e huaj pritet të jetë në nivele negative. Pjesa tjetër e deficitit parashikohet të financohet nga gjendja e mbartur e likuiditetit në vitin 2023.

Deficit Financing		Bln ALL / Mld lekë	Financimi i Deficitit	
A.	Domestic Financing	76.83	A.	Financimi i Brendshëm
<i>of which:</i>			<i>nga të cilat:</i>	
	<i>Net Domestic Borrowing</i>	<i>50.00</i>		<i>Huamarrje e Brendshme Neto</i>
	<i>Other</i>	<i>26.83</i>		<i>Të tjera</i>
B.	External Financing	(15.55)	B.	Financimi i Huaj
<i>of which:</i>			<i>nga të cilat:</i>	

Long-term Borrowing	30.03	Hua Afatgjatë
Repayments	(52.15)	Ripagesa
Budget support	6.57	Mbështetje buxhetore

II. Domestic Government Debt Redemptions in 2024


II. Maturimet e borxhit të brendshëm gjatë 2024

In 2024, a total of about 328.64 bln ALL is expected to mature, of which 217.76 bln ALL are treasury bills and 110.88 bln ALL are treasury bonds.

The instrument with the highest maturities is expected to be a 12-month treasury bill with a value of about **212.77 billion ALL**.

Gjatë vitit 2024 pritet të maturohen në total rreth 328.64 mld lekë, prej të cilave 217.76 mld lekë bono thesari dhe 110.88 mld lekë obligacione.


Instrumenti me maturimet më të larta pritet të jetë bono thesari 12-mujore me vlerë prej rreth **212.77 mld lekë**.



The months with the highest amount of maturing government securities are expected to be January and February precisely with about 58.8 bln ALL and 59.4 bln ALL, where the highest maturities refer to two reference instruments: 3-year and 5-year bonds (respectively 20.83 billion ALL and 18.73 billion ALL), sizes that mark an achievement in the creation of benchmark instruments with the main aim of developing the secondary market. The year 2023 is the second year that the reference instruments are successfully refinanced.

Muajt me shumën më të lartë të maturimeve të borxhit shtetëror pritet të jenë Janar-Shkurt 2024 specifikisht me rreth 58.8 mld lekë dhe 59.4 mld lekë, ku maturimet më të larta i referohen dy instrumentave referencë: obligacione 3-vjeçare dhe 5-vjeçare (respektivisht 20.83 mld lekë dhe 18.73 mld lekë), madhësia e të cilave shënon një arritje në krijimin e instrumentave benchmark me synimin kryesor zhvillimin e tregut sekondar. Viti 2023 është viti i dytë në të cilin rrefinancohen me sukses instrumentat referencë.

Gr. 2. Domestic maturities by month (Bln ALL)
Gr. 2. Maturimet e borxhit të brendshëm sipas muajve (Mld Lekë)



* Maturities for the 12M instrument are based on expectations for December 2023 auction results

III. Borrowing Plan for 2024

III. Plani i Huamarries për 2024

Domestic Financing

In 2024, MFE expects to secure financing in the domestic market through the issuance of the following instruments:

TREASURY BILLS

3 - MONTHS	6 - MONTHS	12 - MONTHS
------------	------------	-------------

TREASURY BONDS

2 - YEARS	3 - YEARS*	5 - YEARS*
7 - YEARS	10 - YEARS	15 - YEARS

* reference instruments

Financimi i brendshëm

Gjatë vitit 2024 MFE pret të sigurojë financimin në tregun e brendshëm përmes emetimit të instrumentave të mëposhtme:

BONO THESARI

3 - MUJORE	6 - MUJORE	12 - MUJORE
------------	------------	-------------

OBLIGACIONE

2 - VJEÇARE	3 - VJEÇARE*	5 - VJEÇARE*
7 - VJEÇARE	10 - VJEÇARE	15 - VJEÇARE

* instrumente referencë

In addition to other standard instruments, the MoFE will continue to issue reference securities, specifically the issuance of two 3-year bonds and two 5-year bonds. Furthermore, the commitment to the further development of the Market Makers Program will continue.

During 2023, MoFE has been engaged in the evaluation of banks participating in the Market Makers program through the Evaluation Methodology, approved by the Instruction of the Minister responsible for finance no. 30, dated 7.11.2022. This assessment will be carried out every 6-months.

Starting from the second quarter of 2024, MoFE intend to conduct auctions for the buyback of government reference instruments maturing in 2025 in order to reduce the refinancing risk of the said year.

Krahas instrumenteve të tjera standarde, MFE do vijojë emetimin e titujve referencë, specifikisht dy linja emetimesh të reja të obligacioneve 3-vjeçare dhe dy linja emetimesh të reja të obligacioneve 5-vjeçare. Më tej, do vijojë angazhimi për avancimin e mëtejshëm të Programit të Zhvilluesve të Tregut.

Gjatë vitit 2023, MFE është angazhuar në vlerësimin e bankave pjesëmarrëse në programin e Zhvilluesve të Tregut nëpërmjet Metodologjisë së Vlerësimit, miratuar me Udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat nr. 30, datë 7.11.2022. Ky vlerësim do të realizohet me një frekuencë 6-mujore.

Duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2024, MFE synon kryerjen e ankandeve për blerjen mbrapsht të titujve qeveritarë referencë që maturohen në vitin 2025 me qëllim uljen e riskut të rifinancimit të atij viti.

Issuance Calendar for 2024

Total issuances are expected to be around **378.64 bln ALL** in 2024.


The most frequently issued instrument in the largest aggregate amount is expected to be the 12-month Treasury bill.

Kalendari i emetimeve për vitin 2024


Totali i emetimeve pritet të jetë rreth **378.64 mld lekë** gjatë vitit 2024.

Instrumenti me emetime më të shpeshta dhe me shumë më të lartë pritet të jetë bono thesari 12-mujore.

Gr. 3. 2024 Issuances by Instruments (Bln ALL)
Gr. 3. Emetimet sipas instrumeneteve në 2024 (mld lekë)



Gr. 4. 2024 Issuances by Months (Bln ALL)
Gr. 4. Emetimet sipas muajve në 2024 (mld lekë)



The table below illustrates the issuance frequency for each instrument/month.

Tabela më poshtë ilustron frekuencën e emetimeve për secilin instrument/muaj.

Instrument	Issuance frequency by instrument/month for 2024* <i>Frekuenca e emetimeve sipas instrumeteve/muajve gjatë 2024*</i>											
	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec
3M	X						X					
6M		X				X						
12M	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
2Y Fix	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
3Y Fix		X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
5Y Fix	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
7Y Fix		X	X		X	X	X		X	X	X	
10Y Fix	X			X			X			X		
15Y Fix		X			X			X			X	

Instrument	Price mechanism / Mekanizmi i Cmimit	Issuance Frequency / Frekuenca e emetimit	Issuance amount per auction / Shuma e emetimit për ankand
3M	Multiple / Me shumë çmime	2 x Year/Vit	1 bln ALL / mld lekë
6M		2 x Year/Vit	1 bln ALL / mld lekë
12M		2-3 x Month/Muaj	6 – 14 bln ALL / mld lekë
2Y fix	Uniform	1 x Month/Muaj	2 – 10 bln ALL / mld lekë
3Y fix	Multiple / Me shumë çmime	1 x Month/Muaj	2 – 5 bln ALL / mld lekë
5Y fix		1 x Month/Muaj	3 – 4 bln ALL / mld lekë
7Y fix	Uniform	8 x Year/ Vit	3-4 bln ALL / mld lekë
10Y fix	Uniform	4 x Year/ Vit	3-4 bln ALL / mld lekë
15Y fix	Uniform	4 x Year/ Vit	1.5-2 bln ALL / mld lekë

* Considering the uncertainty that the year 2024 presents, MFE reserves the right to change the frequency or amount to be issued for each instrument/month based on market conditions.

* Duke konsideruar pasigurinë që viti 2024 paraqet, MFE rezervon të drejtën që të mund të ndryshojë frekuencën apo shumën e emetimit për instrument/muaj sipas kushteve të tregut.

External Financing

Long term borrowing	36.6 bn ALL
Project Financing	30.03 bn ALL
Budget support	6.57 bn ALL
Repayments	52.15 bn ALL
Net External Financing	-15.5 bn ALL

Financing from external sources is expected to be realized mainly through disbursements of loans financing the priority investment projects of the government and also disbursement of the budget support loans which steps and conditions may be fulfilled during 2024.

In total, foreign borrowing during 2024 is estimated to be around 36.6 billion Lek, and considering the foreign debt that is to be repaid during the year, net foreign borrowing is expected to be at negative levels of (minus) 15.6 billion Lek.

In the event that market conditions during 2024 will be favorable, it is not excluded the option of advancing in 2024 the issuance of a new Eurobond, which is foreseen in the 2025 budget year.

The project financing will consist on loan disbursement for initiated projects that are under implementation with funding from WB, KfW, EBRD, EIB and other important development institutions.

Financimi i jashtëm

Hua afatgjatë	36.6 bn ALL
Për projekte	30.03 bn ALL
Mb. buxhetore	6.57 bn ALL
Ripagesa	52.15 bn ALL
Financimi Neto i Jashtëm	-15.55 bn ALL

Huamarrja e huaj parashikohet të realizohet kryesisht nëpërmjet disbursimit të huave që financojnë zbatimin e projekteve prioritare të qeverisë, si dhe disbursimit të mbështetjeve buxhetore procedurat dhe kushtet paraprake të të cilave mund të arrijnë të plotësohen gjatë vitit 2024.

Në total huamarrja e huaj gjatë vitit 2024 vlerësohet të jetë rreth 36.6 miliardë Lek, dhe duke konsideruar borxhin e huaj që ripaguhet gjatë vitit, huamarrja neto e huaj pritet të jetë në nivele negative prej (minus) 15.6 miliardë Lek.

Në rast se kushtet e tregjeve gjatë vitit 2024 do të jenë të favorshme, nuk përjashtohet mundësia e avancimit në kohë me emetimin përgjatë vitit buxhetor 2024 të një Eurobondi të ri, i cili është parashikuar në vitin buxhetor 2025.

Financimi i projekteve do të konsistojë në disbursimin e kredive për projektet e nisura që janë në zbatim me financimin e BB, KfW, BERZH, BEI, dhe financuesve të tjerë të rëndësishëm.

A budget support is planned to be realized and disbursed within the year 2024 within the framework of policies to support renewable capacity and green development of Albania, in the amount of EUR 60 million.

In addition, during 2024 may be disbursed also the Budgetary Support loans which are planned and were in process of approval during 2023.

Një mbështetje buxhetore është planifikuar të realizohet dhe të disbursohet brenda vitit 2024 në kuadër të politikave për të mbështetur aftësinë përtëritëse dhe zhvillimin e gjelbërt të Shqipërisë, në vlerën prej 60 milionë EUR.

Gjithashtu, gjatë 2024, në zërin e Mbështetjeve Buxhetore, mund të përfshihet dhe ndonjë nga Mbështetjet Buxhetore që ka qënë e planifikuar dhe në proces miratimi gjatë vitit 2023.

IV. Debt Management Strategy and Risk Indicators

IV. Strategjia e Menaxhimit të Borxhit dhe Indikatorët e Riskut

One of the main objectives set in the Medium-Term Debt Management Strategy is to meet the needs to service current debt at the lowest possible cost while maintaining acceptable levels of risk exposure.

The Ministry of Finance and Economy, in the context of proper debt management, has continued its efforts in the direction of reducing exposure to risks while keeping the cost at the lowest possible level according to market conditions.

In contrast to the year 2022, where due to tight market conditions the risk indicators could not develop entirely in the direction of the strategic objectives, during 2023, the risk management of the debt portfolio was able to evolve in the direction of the medium-term strategic objectives showing improvement in all indicators, compared to the end of 2022.

Një ndër objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit është plotësimi i nevojave për të shërbyer borxhin aktual me kosto sa më të ulët, duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj risqeve.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të mirëmenaxhimit të borxhit ka vijuar përpjekjet në drejtim të reduktimit të ekspozimit ndaj risqeve duke mbajtur koston në nivelin më të ulët të mundshëm sipas kushteve aktuale të tregut.

Në ndryshim nga viti 2022, ku për shkak të kushteve të shtrënguara të tregjeve treguesit e riskut nuk ecën plotësisht në drejtim të objektivave strategjike, gjatë vitit 2023, menaxhimi i risqeve të portofolit të borxhit ka mundur të evoluojë në drejtim të objektivave strategjike afatmesëm duke shfaqur përmirësim në të gjithë treguesit, krahasuar me fundin e vitit 2022.

Risk Indicators (Indikatorët e Riskut)	2018	2019	2020	2021	2022	2023 (exp)	MTDS Target 2026
Interest rate risk (Risku i normave të interesit)							
Debt Refixing within 1 year (Borxhi që rifiksohet brenda 1 viti)	54.3%	50.9%	46.7%	48.0%	49.0%	46.8%	Max 43%
ATR (KMR*)	2.06	2.11	2.14	2.19	2.17	2.35	Min 2.5
Refinancing risk (Risku i rificancimit)							
Debt which matures within 1 year (Borxhi që maturohet brenda 1 viti)	49.4%	47.7%	44.8%	46.6%	49.0%	47.0%	Max 40%
ATM (KMM**)	2.17	2.19	2.18	2.20	2.17	2.36	Min 2.5

* Average Time To Refixing (in years) / Koha mesatare në rifiksime (në vite)

**Average Time to Maturity (in years) / Koha mesatare në maturim (në vite)

After the end of the calendar year 2023, in accordance with the Medium-Term Debt Management Strategy, a monitoring report will be drafted. The report will include, the progress made on risk indicators including relevant circumstances that have influenced, according to the format defined in the MTDS.

During the year 2024, the objective is to further improve the risk indicators in accordance with market conditions, while ensuring the necessary financing for the year and keeping the cost at the lowest possible level.

Pas përfundimit të vitit kalendarik 2023, në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit do të hartohet një raport monitorimi i cili do të përfshijë ndër të tjera dhe ecurinë e treguesve të riskut si dhe rrethanat përkatëse që kanë ndikuar, sipas formatit të përcaktuar në SAMB.

Gjatë vitit 2024, do të synohet përmirësimi i mëtejshëm i treguesve të riskut, sipas kushteve të tregut, duke siguruar financimin e nevojshëm dhe mbajten e kostos në nivelin më të ulët të mundshëm.

V. Related links

V. Faqet e internetit përkatëse

Ministry of Finance and Economy

www.financa.gov.al

Bank of Albania

www.bankofalbania.org

Albanian Financial Supervisory Authority

www.amf.gov.al

Published information related by MOFE

Issuance Calendar / Kalendar i Emetimeve

<https://financa.gov.al/kalendar-i-emetimeve/>

Auction Results / Rezultatet e ankandeve

<https://financa.gov.al/2023-2/>

Contacts

Kontakte

General Directorate of State Debt

Kesjana Halili, General Director Kesjana.Halili@financa.gov.al

Belina Memeti, Director of Borrowing: Belina.Memeti@financa.gov.al

Ina Memisha, Head of Domestic Borrowing Unit: Ina.Memisha@financa.gov.al